

KONTRATE TRANSFERIM KAPITALI

E lidhur ne Sarande sot me daten 8/01/1999, ditën e premte, midis paleve kontraktuese:-----

TRANSFERUESIT: DHAMIANO ÇAKALLI, I BIRI I LLAMBROS, I DATELINDJES 1962, LINDUR NE PILUR DHE BANUES NE SARANDE, LAGJA NR.2, ME ZOTESI JURIDIKE DHIMITER DUKA, I BIRI I SOKRATIT, I DATELINDJES 1972, LINDUR NE PILUR DHE BANUES NE SARANDE, LAGJA NR.2, ME ZOTESI JURIDIKE.
PRANUESIT: SIMON ÇIPA, I BIRI I JOSIFIT, I DATELINDJES 1965, LINDUR DHE BANUES NE LAGJEN NR.2, SARANDE, ME ZOTESI JURIDIKE.
JANI MIHA, I BIRI I SPIROS, I DATELINDJES 1958, LINDUR NE KRON-GJ DHE BANUES NE SARANDE, LAGJA NR.1, ME ZOTESI JURIDIKE.

Palet me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar lidhen kete kontrate per transferimin e kapitaleve:-----

Me vendimin nr.17928 date 16/10/1997 te Gjykates se rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin "DHIMIAMON"SH.P.K.-----

Me vendimin nr.1 date 8/01/1999 te Asamblese se ortakeve te shoqerise ortakët Dhamiano Çakalli dhe Dhimiter Duka me deshiren e tyre largohen nga shoqeria dhe kuotat e tyre ne kapitalin fillestar prej 100.000 lekesh ose 100 kuota qe jane nga 33 ose 33.000 leke ja transferojne perkatesisht ortakut qe ngelet ne shoqeri Simon Çipa dhe Jani Miha i cili pranon qe te futet ne shoqeri si ortak i ri me deshiren e tij. Ortaku Simon Çipa kishte 34 kuota ose 34.000 leke ne kapitalin fillestar. Ne kushtet e transferimit te kapitaleve Simon Çipa pranon 32 kuotat edhena ose 3200 leke nga ortakët Dhamiano Çakalli. Ortaku i ri ne shoqeri Jani Miha pranon 33 kuotat e dhena ose 33.000 leke nga ortakët Dhimiter Duka dhe 1 kuot ose 1.000 leke nga ortakët **Dhamiano Çakalli.**-----

Ne keto kushte ortakët Simon Çipa behet me 66 kuota ose 66.000 leke dhe ortakët i ri ne shoqeri Jani Miha me 34 kuota ose 34.000 leke ne kapitalin fillestar prej 100.000 lekesh ose 100 kuota.-----

Palet likujdimet i kane bere paraprakishte dhe ne keto kushte jane dakorte me formulimin e kesaj kontrate.-----

Kontrata e transferimit te kapitaleve bezohet ne nenet 47 dhe 49 te ligjit nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ne statuti e shoqerise.-----

Persa me siper meqenese eshte ne perputhje me ligjin dhe vullnetin e lire te paleve nenshkruhet rregullishte prej tyre.-----

TRANSFERUESIT

PRANUESIT

DHAMIANO ÇAKALLI

DHIMITER DUKA

SIMON ÇIPA

JANI MIHA